

Spring 3-2021

## **FIND-DOCTOR APPLICATION**

Kastriot Beha

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Computer Sciences Commons](#)

---

### **Recommended Citation**

Beha, Kastriot, "FIND-DOCTOR APPLICATION" (2021). *Theses and Dissertations*. 2612.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2612>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinierise

**FIND-DOCTOR APPLICATION**

Shkalla Bachelor

Kastriot Beha

Mars/2021  
Prishtinë



Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinierise

Punim Diplome  
Viti Akademik 2017-2020

Kastriot Beha

**FIND-DOCTOR APPLICATION**

Mentori: Ramiz Hoxha

Mars / 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor

## **ABSTRAKT**

Nëpërmjet kësaj ideje unë synojë të krijojë një web aplikacion i cili u mundëson përdoruesëve të kërkojnë mjekë të departamenteve të ndryshme sipas nevojave të secilit përdorues. Renditja e mjekëve pas kërkimit nga ana e përdoruesve apo pacientëve bëhet përmes rating(vlerësimit) nga doktori më i mirë pra doktori me rating më të lartë deri tek doktori me rating më të ulët.

Përveq renditjes së mjekëve ne ofrojmë edhe statistika apo charts për të treguar top 5 mjekët më të mirë, në mënyrë që përdoruesve të ju lehtësojmë gjetjen e doktorit të caktuar dhe të duhurit për nevojat e tyre.

Poashtu përdoruesit mund edhe të vlerësojnë mjekët në aplikacion si dhe të shtojnë komente të caktuara për secilin mjekë.

Kërkimi i mjekëve në aplikacion mund të bëhet përmes çfarëdo pajisje elektronike qoftë ai laptop apo telefon-mobil pasi që ne do të ofrojmë atyre një responsivitet të plotë. Të gjitha të dhënat do të ruhen në NoSQL databazë (MongoDB) dhe ato të dhëna do të shfaqen të përdoruesi, aplikacioni do të dizajnohet në dy module së pari për pacientët i cili përdor aplikacionin dhe kërkon mjekët e ndryshëm përmes web aplikacionit dhe për mirëmbajtësit e web aplikacionit të cilët përditësojnë mjekët, të dhënat e tyre në bazë të arritjeve dhe punës të secilit mjekë.

Regjistrimi i të dhënave në web-aplikacion do të mund të bëhet përmes ekraneve të ndryshme dhe vetëm nga personat e autorizuar.

## **MIRËNJOHJE/FALENDERIME**

Së pari do të doja të falënderoja mentorin tim, profesorin Ramiz Hoxha, ekspertiza e të cilit ishte e paçmuar në formulimin e pyetjeve dhe metodologjisë së hulumtimit. Reagimi juaj i zgjuar më shtyu të theksoj të menduarit dhe e solli punën time në një nivel më të lartë.

Unë gjithashtu do të doja të falënderoja tutorët e mi, Betim Gashi ,Arbër Kadriu dhe Medina Shamolli, për udhëzimet e tyre të vlefshme gjatë studimeve të mia. Ju më siguroat mjetet që më duheshin për të zgjedhur drejtimin e duhur dhe për të përfunduar me sukses disertacionin tim. Përveç kësaj, unë do të doja të falënderoja prindërit e mi për këshillat e tyre të mençura dhe motivimet të cilat më kanë japur. Ju jeni gjithmonë aty për mua. Më në fund, nuk mund ta kisha përfunduar këtë disertacion pa mbështetjen e miqve të mi, kolegëve, të cilët ofruan diskutime stimuluese si dhe shpërqendrim të lumtura për të pushuar mendjen time jashtë hulumtimit tim.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E FIGURAVE.....</b>	<b>V</b>
<b>LISTA E TABELAVE.....</b>	<b>VI</b>
<b>FJALORI I TERMAVE.....</b>	<b>VII</b>
<b>1 HYRJE.....</b>	<b>1</b>
<b>2 SHQYRTIMI I LITERATURES .....</b>	<b>2</b>
2.1 Fushëveprimi I Projektit(Project Scope) .....	2
2.2 Analiza Teknike Dhe Teknologjike E Sistemit.....	3
2.3 Analiza e Projektit X(doctorondemand.com).....	7
2.4 Analiza Teknike Dhe Teknologjike(doctorondemand.com).....	7
2.4.1 Hyrje .....	7
2.4.2 Përparësitë e Java.....	8
2.4.3 Përparësitë e Vue.js.....	10
2.5 Krahasimi I Gjuhëve Programuese .....	10
2.5.1 Node.js VS Java.....	10
2.5.2 Krahasimi i front-end: React.js dhe Vue.js:.....	13
Menaxhimi i Gjendjës së të Dhënave .....	15
Performanca .....	15
Shkallzueshmëria .....	16
Verdikti .....	17
2.6 MONGODB VS SQL .....	17
2.6.1 Historia.....	18
2.6.2 Si ruhen të dhënat.....	18
2.6.3 Besueshmëria .....	19
2.6.4 Skema.....	20
2.6.5 Query.....	20
<b>3 DEKLARIMI I PROBELMIT.....</b>	<b>23</b>
3.1 QFAR OFRON KY SISTEM.....	23
3.2 TEKNOLOGJITE E PERDORURA.....	23
<b>4 METODOLOGJIA .....</b>	<b>26</b>

4.1	Scrum .....	26
<b>5</b>	<b>REZULTATET .....</b>	<b>28</b>
5.1	Rezultatet e aplikacionit ne fjale .....	28
<b>6</b>	<b>DISKUTIMI DHE PERFUNDIMI.....</b>	<b>30</b>
<b>7</b>	<b>REFERENCAT .....</b>	<b>33</b>
<b>8</b>	<b>APPENDIXES.....</b>	<b>34</b>

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. UBT Logo.....	1
Figura 2.4.1 Procesi i Threads.....	9
Figura 2.5.1. Lista e Frameworks.....	14
Figura 3.1. Procesi I Funksionit te Redux.....	25
Figura 4.1 Scrum Metodologjia.....	27
Figura 5.1 Gjetja e Doktorit sipas departamentit.....	28
Figura 5.2 Listimi i Doktorave sipas departamentit te caktuar.....	29
Figura 5.3 Listimi i Doktorave.....	32



## **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1. Specifikimi i sistemit operativ.....	6
Tabela 2. Dallimi Java – Node.js.....	12
Tabela 3. Specifikimi i Sprintave.....	31

## **FJALORI I TERMAVE**

CMS – Content Management System

SSD – Solid State Drive

TDD – Test Driven Development

CPU – Central Processing Unit

SEO – Search Engine Optimization

JSON - Java Script Object Notation

JDK - Java Development Kit



# 1 HYRJE

Nëpërmjet kësaj ideje unë synoj të krijoj një web aplikacion i cili u mundëson përdoruesëve të kërkojnë mjekë të departamenteve të ndryshme sipas nevojave të secilit përdorues. Renditja e mjekëve pas kërkimit nga ana e përdoruesve apo pacientëve bëhet përmes rating(vlerësimit) nga doktori më i mirë pra doktori me rating më të lartë deri tek doktori me rating më të ulët.

Përveq renditjes së mjekëve ne ofrojmë edhe statistika apo charts për të treguar top 5 mjekët më të mirë, në mënyrë që përdoruesve të ju lehtësojmë gjetjen e doktorit të caktuar dhe të duhurit për nevojat e tyre.

Poashtu përdoruesit mund edhe të vlerësojnë mjekët në aplikacion si dhe të shtojnë komente të caktuara për secilin mjekë.

Kërkimi i mjekëve në aplikacion mund të bëhet përmes çfarëdo pajisje elektronike qoftë ai laptop apo telefon-mobil pasi që ne do të ofrojmë atyre një responsivitet të plotë. Të gjitha të dhënat do të ruhen në NoSQL databazë (MongoDB) dhe ato të dhëna do të shfaqen të përdoruesi, aplikacioni do të dizajnohet në dy module së pari për pacientët i cili përdor aplikacionin dhe kërkon mjekët e ndryshëm përmes web aplikacionit dhe për mirëmbajtësit e web aplikacionit të cilët përditësojnë mjekët, të dhënat e tyre në bazë të arritjeve dhe punës të secilit mjekë.

Regjistrimi i të dhënave në web-aplikacion do të mund të bëhet përmes ekraneve të ndryshme dhe vetëm nga personat e autorizuar.

## 2 SHQYRTIMI I LITERATURES

### 2.1 Fushëveprimi i Projektit(Project Scope)

Qëllimi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i një web aplikacion i cili u mundëson përdoruesëve të kërkojnë mjekë të departamenteve të ndryshme sipas nevojave të tyre. Ky aplikacion do të ketë të gjitha tiparet për përdoruesit, për të ju mundësuar atyre një përdorim sa më të lehtë të sistemit. Do të mundësojë vizitorëve të kërkojnë mjekë të departamenteve të ndryshme, pasi që aplikacioni përmban një kërkim të sofistikuar për përdoruesit për të kërkuar mjekë specifike për nevojat e tyre.

Fusha e kërkimit (Search bar) ofron një mënyrë të lehtë dhe të përshtatshme për kërkimin e mjekëve ku automatikisht do të përmirësojë mjekët e kërkimit në dispozicion bazuar në të dhënat e përdoruesit. Përdoruesi pastaj mund të shohë specifikat e plotë të secilit mjekë. Ata do të kenë mundësinë të shkruajnë përshtypjet e tyre dhe të japin një vlerësim (rating ) për ndonjë mjekë të caktuar.

Web-aplikacioni në fjalë është i dizajnuar dhe do të qëndrojë online 24orë në 7 ditët e javës e që kjo do të thotë se përdoruesit mund të shfletojnë në web-aplikacionin tonë në çfarëdo kohe që ata dëshirojnë gjithashtu vlen të përmendet se sistemi ofron edhe një kontakt form ku ne si ekip do të jemi në dispozicion për përdoruesit për të marrë kritika positive apo negative, se qfarë duhet të përmisojmë apo të shtojmë në aplikacion.

Pasi që projekti është i bazuar në aktivitete që zhvillohen tërësisht online në duhet të mendojmë edhe për sigurinë dhe ta vendosim si një ndër qështjet primare të projektit të find-doctor, pra ne si ekip do ta ndërtojmë sistemin në fjalë të atillë që të ketë një siguri në nivelin e caktuar pra do të ndajmë grupet e përdoruesve, pra do të kemi autentifikim që do të thotë do të ndajmë userat në 3 grupe , usera pa mode të autentifikimit pra guests pastaj usera me modin user në mënyrë që të

mund të bëjnë vlerësime dhe të shtojmë komente për mjekët e caktuar, pastaj usera me modin moderator këta do të jenë përgjegjës për regjistrimin e mjekëve dhe admin i cili u jep qasje userave në mode të caktuar, e gjithë kjo do të arrihet përmes mongodb apo node js

passport gjithashtu në mënyrë që web të jetë i mbrojtur nga ddos sulmet do të përdorim cdn e që në rastin tonë cloudflare,

dhe nëse ne përcjellim dhe zbatojmë hapat e lartpërmendur ne do tu ofrojmë përdoruesve të platformës sonë të qasën dhe të vazhdojnë me kërkimet e tyre për nevojat e tyre në çdo kohë dhe nga çdo platformë që ata përdorin. Pasi që web-aplikacioni është tërësisht online ai do të jetë i lehtë për tu qasur në çdo kohë dhe çdo paisje.

## **2.2 Analiza Teknike Dhe Teknologjike E Sistemit**

Disa konsiderata duhet të merren parasysh për të vendosur metodologjinë që do të përdoret në këtë projekt siç janë shtrirja, koha, rreziqet dhe objektivat të cilat ne duhet ti përmbushim. Në fillim do të kemi vetëm modulet normale të webit për kërkim të mjekëve. Ku si fillim do të regjistrojmë mjekët e departamenteve të caktuara për të parë se si do të jetë reagimi i përdoruesve për web-aplikacione të tilla si Find-Doctor dhe se si përdoruesit do të ambientohen në një web të tillë, por para kësaj ne fillimisht vetë si staf (ekip) do të bëjmë testimin dhe të shohim se sistemi a është i përshtatshëm për përdoruesit, që ata të mundën me gjetë mjekun e duhur për nevojat e tyre në mënyrë sa më të lehtë dhe më të shpejtë, dhe pastaj përdoruesit do të kenë mundësi për feedback.

Shtimi i moduleve të reja të cilat vijnë së bashku me evolucionin e projektit, pasi që është edhe diçka e re për klientët mbrenda një kohe të caktuar do të shtohet nevoja për krijim të moduleve të reja si dhe për oferta të ndryshme për klientët shtimi i mjekëve do të shtohet dhe do të rritet pasi do të vërehet se kjo është mënyra më e mirë për të i plotësuar nevojat e secilit përdorues, kjo është edhe diçka e mirë edhe për përdoruesit sepse përdoruesit do të kenë mundësi të ndryshme të përzgjedhjes së mjekëve të preferuar. Në web aplikacionin tonë do të kemi akses (qasje) vetëm userat me modin moderator për të vlerësuar dhe komentuar mjekët e ndryshëm në aplikacion.

Përdoruesit tanë do të kenë mundësinë e kërkimit dhe vlerësimit të mjekëve ndërsa ata pastaj vetëm kontaktojnë në forma të caktuara me ne se cilë doktorë apo departamente dëshirojnë ti postojnë në Find-Doctor. Viruset (spam email), ngacmimi virtual cyber bullying, hyrja ne web faqen tonë nga link-u/adresa zyrtare, kriptimi i te dhënave, mbrojtja antivirus, firewall, antispyware, Bllokimi / Lock out Automatik. Pas nje numri tentativash të dështuara për të hyrë në llogarinë online, ne ç'aktivizojme llogarine tuaj. Per te riaktivizuar llogarinë tuaj juve ju duhet të kontaktoni sherbimin Help ose administratën.

Time out / Skadimi kohor i Sesionit. Nëse ju harroni të dilni në mënyre korrekte (log off) paisja pasi e përdorni atë ose nëse kompjuteri juaj qëndron jo aktiv gjate nje sesioni atëherë sistemi ynë ju nxjerr automatikisht nga llogaria juaj.Login do të ofrohet nga sistemi i jonë i autentifikimit por ne do tu ofrojmë përdoruesëve të Find-Doctor edhe mënyra tjera të qasjes në sistem ku si sistem të jashtëm kemi vendosur që të përdoret vetëm google login,pasi është një sistem in-house nuk ka nevoj për përdorim e sistemeve tjera.Të ilustrojm pak se përse përdoret google login.Ne e dimë që kryesisht aplikacionet të cilat përdoren sot që kanë të bëjnë me porosi si dhe pagesa kryesisht përdoret një login form,në këtë drejtim google është zhvilluar mjaft shumë duke mundsuar implementimin e një login gjenerik për qfardo lloj aplikacioni.Arsyeja se pse ne kemi vendosur që të përdoret google login është për lehtësim në përdorim te aplikacionit tonë nga ana e përdoruesit duke mundësuar kështu përmes një gmail account të mundet të kyqet në aplikacionin tonë kështu duke mos e frustruar atë në krijimin e një email të ri të cilin e kemi hasur në disa prej aplikacioneve të cilat krijohen në ditet e sotme duke mos qenë dhe një zgjidhje adekuate,ndërsa sa i përket sistemit të kyqjes që do të zhvillohet nga ne si ekip do të përdorim mongodb si databazë real time dhe sistemin e autentifikimit për verifikimin e userave të cilët qasen në Find-Doctor.

Ne si ekip jemi të pregaditur për zhvillimin e projektit në fjalë falë përvojës te antareve te zhvillimit.Projekti ynë do të bazohet në teknologjinë MEVN që do të thotë (Mongo-si databzë,Express.js-si framework të cilin e përdorë Node.js,React-si front-end framework për SPA web aplikacione dhe Nodejs si javascript runtime environment dhe Mongodb krejt në fund e cila do të na shërbej për ruajtjen e përdoruesëve dhe autentifikimin e tyre në Find-Doctor).Ruajtja e mjekëve të cilët gjenden në Find-Doctor do të ruhen në databazën e llojit NoSql pra që në këtë rast

ne do të përdorim si databazë të llojit të tillë MongoDB pse? Sepse është më e shpejtë në krahasim me databazat e tipit SQL pastaj ka performancë të lartë , shkallëzim automatik , e thjeshtë për instalim dhe mirëmbajtje gjithashtu e lehtë për tu implementuar dhe gjithashtu përdor dokumente JSON apo BSON formate.Kjo databazë do të komunikojë me front-end përmes Node JS e cila do të jetë përgjegjëse për request që bëhen nga përdoruesit dhe pastaj të merr ato të dhëna dhe ti shfaq tek përdoruesi në formate të caktuara.

Arsyet pse do të përdori node js dhe jo ndonjë platformë tjetër është sepse i tërë sistemi është i bazuar në javascript si gjuhë programuese dhe si të tillë edhe node js është i bazuar në javascript pastaj është lightweight dhe i shpejtë për arsye që është asinkron konsumimi i API është më i lehtë dhe mbi të gjitha përdoret për teknologji real-time dhe për fund si teknologji do të përdorim react js ngase është një front-end javascript framework dhe na mundëson ndërtimin e web-aplikacioneve si single (SPA) gjë e cila e bën një web app jashtëzakonisht të shpejtë e sidomos në request e gjitha kjo arrihet falë router i cili na mundëson React teknologjia ndërsa bashkë me atë do të instalojmë edhe plugins të tjerë përmes npm package manager si psh axios për get apo post ose put requesta etj,shkurtimisht ky ishte një përshkrim i asaj se çka do të përdorim gjatë zhvillimit në front-end dhe në back-end.

Ndërsa sa i përket hostimit (deploy) aplikacionin tonë do ta bëjmë deploy në sisteme operative të bazuara në kernelin e Linux pse?sepse do të ulim kostot e projektit sepse nëse do të kishim përdorur windows server do të kishim pasur kosto shumë më të larta për arsye të licensave që duhet blerë e për këtë arsye ne si ekip gjatë diskutimit dhe analizimit kemi vendosur që të përdorim linux sisteme operative e konkretisht ubuntu distro të blerë nga digital ocean të shoqëruar me apache web server së bashku me nginx web server duke e përdorur atë si proxy server dhe e fundit domain do të blihet fillimisht për një periudhë një vjeqare nga regjistrar të domain sistemeve siq janë go daddy apo HostGator ne do të zgjedhim në mes të këtyre dy kompanive varësisht qmimit që ata na e ofrojnë ne.Për të arritur maksimumine dyqanit tonë online në mënyrë që të tërheqim sa më shumë vizitorë dhe numri i klientëve të rritet ne do të përdorim analiza të informacioneve siq janë Google Analytics,analiza e web duhet të bëhet përdoruesit të dukshme për ndryshe bëhet shumë vonë , analiza në kohë të rregullt e Find-Doctor do të ndihmojë në identifikimin e problemeve që përdoruesit tonë hasin si psh gjatë kërkimit të një mjeku.



Gjithashtu ne përmes analizave të web kemi mundësi të shohim se cili doktor kerkohet me shume nga perdoruesit e aplikacionit tone.Pra ne përmes google analytics ne do të arrijmë të optimizojmë Find-Doctor web aplikacionin . Pra krejt në fund mund të themi se zhvillimi i sistemit të Find-Doctor përmban këto aktivitete të cilat po përpiqem ti listojë më poshtë: sistemi do të jetë userfriendly përgjatë gjithë moduleve të sistemit,mënyra se si është i ndërtuar sistemi në fjalë e bënë atë lehtë të menaxhueshëm,pastaj garantojmë se nuk do të ketë keq menaxhim të të dhënave të përdoruesëve ngase ato do të enkriptohen dhe si të tilla ruhen në Mongoddb,mundëson nivel të lartë të autentifikimit të përdoruesëve në mënyrë të parandalimit të keqpërdorimit të tyre,dhe krejt në fund sistemi do të ketë një performancë jashtzakonisht të shpejtë dhe optimale në krahasim me aplikacionet tjera.Disa nga funksionet tjera që do të ketë sistemi jonë e që më lart nuk janë të përmendura janë :CMS për menagjim të webit ,lojalitete,vouchers,promocione me email etj.

Ndërsa sa i përket mënyrës së deploy ky web aplikacion do të bëhet host me një server virtual Vps që do ta blejmë nga kompania Digital Ocean i bazuar ne sitemin operativ ubuntu dhe me këto specifika:

Ram	V-Cpu	Transfer bw	SSD	Qmimi/muaj
16Gb	8Core	6TB	320GB	80\$

Tabela1-Specifikat e sistemit operativ

Kur klienti qaset në Find-Doctor ai ka mundësinë e navigimit për të parë mjekë të ndryshëm, ka mundësinë e vlerësimit dhe për të shtuar komente për secilit mjekë por si fillim ai duhet të jetë i regjistruar dhe i kyqur.Përdoruesi mund të përdorë edhe login with google për të u kyqur ne aplikacionin Find-Doctor.Si dhe duhet të ceket se përdoruesit te cilet regjistrohen ne aplikacion atëherë duhet të verifikojn email adresen e tyre, pra nuk munden me qdo email te regjistrohen, kjo ka rendesi sepse nese kemi nevojë te dergojm email-e te ndryshme tek perdoruesit e ndryshem per ndonje feedback athere duhet te sigurohemi qe te gjith perdoruesit e sistemit janë real me te dhenat e tyre.

## **2.3 Analiza e Projektit X(doctorondemand.com)**

Qëllimi kryesor i këtij projekti doctorondemand.com është zhvillimi i një aplikacioni i cili do të ju mundësoj përdoruesve të bëjnë video chat me doktorin e caktuar. Ky aplikacion i ka të gjitha tiparet për klientët të cilët janë të intereuar dhe kanë nevojë të komunikojn. Të bëjnë video chat me një mjek të caktuar.Do të ju mundësoj përdoruesve te sistemit te regjistrohen, te kyqën ne aplikacion, dhe pastaj ata kanë mundësin që të zgjedhin llojin e mjekut pra departamentin e pastaj e zgjedhin mjekun e caktuar për të bërë video chat me të.

Përdoruesi pastaj mund të shohë specifikat e plota të secilit mjekë, ngjashem pra sikur në aplikacionin Find-Doctor.Web-aplikacioni në fjalë është i dizajnuar dhe do të qëndrojë online 24orë në 7 ditët e javës e që kjo do të thotë se klientët mund të shfletojnë në web-aplikacionin dhe të kërkojnë mjekë të caktuar per video-chat në çfarëdo kohe që ata.Ky web-aplikacion është tërësisht online dhe është i lehtë për tu qasur në çdo kohë dhe çdo paisje, duke ofruar responsivitet të plotë.

## **2.4 Analiza Teknike Dhe Teknologjike(doctorondemand.com)**

### **2.4.1 Hyrje**

Aplikacioni doctorondemand.com si back-end përdorin java, kurse ne front-end vue.js si dhe json formatin për shkëmbimin e informacioneve midis klientit dhe serverit. Le të analizojm pak gjuhët programuese të përdorura nga doctorondemand.com:

Java: Java është një gjuhë programuese me qëllim të përgjithshëm që ndjek paradigmen e programimit të orientuar drejt objektit dhe qasjen: ‘Shkruaj një herë ekzekuto kudo’. Java përdoret për aplikacione desktop, ueb, mobile. Java nuk është vetëm një gjuhë por një ekosistem mjetesësh që mbulon pothuajse gjithçka që mund t’ju duhet për zhvillimin e Java development. Kjo përfshin:

Java Runtime Environment (JRE) - mjet për shpërndarjen e softverit që përmban një Makinë Virtuale Java të pavarur, librarinë standarde Java (Java Class Library) dhe një mjet konfigurimi.

Java mund të gjendet kudo që të shikoni. Është një gjuhë kryesore për zhvillimin e Android. Do ta gjeni në aplikacione në internet, faqet e internetit qeveritare dhe teknologjitë e të dhënave të mëdha siç janë Hadoop dhe Apache Storm. Dhe është gjithashtu një zgjedhje klasike për projekte shkencore, veçanërisht përpunimin e gjuhës natyrore (natural language processing). Java ishte duke dominuar mobilen edhe në ditët para smartphone-it - lojërat e para me celularë në fillimin e viteve 2000 u bënë kryesisht në Java. Pra, është e drejtë të thuhet se Java, falë historisë së saj të gjatë, ka fituar vendin e saj në Sallën e Famës të Programimit. Indeksi TIOBE, një nga renditjet më të njohura të programimit në botë, përdor rezultatet e motorëve të kërkimit për llogaritjen. Përkundër popullaritetit në rritje të Go dhe Python, Java ka mbetur në krye të listës për më shumë se një dekadë.

### **2.4.2 Përparësitë e Java**

**Fleksibiliteti:** Java provoi që kodi procedural, i alokuar manualisht dhe i varur nga platforma i C nuk ishte gjithçka. Falë Java-s, më shumë njerëz filluan të adoptojnë programim të orientuar drejt objektit, një praktikë e përdorët edhe sot.

**Test-driven development:** Me Java, TDD nuk ishte më një praktikë eksperimentale, por mënyra standarde për të zhvilluar softuerin. Futja e JUnit në vitin 2000 konsiderohet si një nga kontributet më të mëdha të Java-s.

**Multithreading:** Në programim, një thread është njësi më e vogël e përpunimit. Për të maksimizuar shfrytëzimin e kohës së CPU, Java ju lejon të ekzekutoni këto thread njëkohësisht - në një proces të quajtur multithreading. Threads ndajnë të njëjtën zonë të memories kështu që kalimi midis tyre kërkon pak kohë.

Ata janë gjithashtu të pavarur, kështu që nëse një thread përballet me exception, nuk ndikon në threads e tjera. Kjo është veçanërisht e dobishme për lojëra dhe programe të rënda për animacione.



Fig 2.4.1-Proceset e threads

Sa i përket front-end nga ondemand.com kanë përdorur Vue.js:

Historia e Vue.js fillon në 2013 kur Evan You po punonte në Google duke krijuar shumë prototipa brenda një shfletuesi. Për atë qëllim, Evan përdori praktika të dobishme nga kornizat e tjera me të cilat ai punoi dhe lëshoi Vue.js zyrtarisht në 2014.

Vue.js është një kornizë progresive për JavaScript që përdoret për të ndërtuar ndërfaqe në internet dhe aplikacione me një faqe. Jo vetëm për ndërfaqet në internet, Vue.js përdoret gjithashtu si për zhvillimin e aplikacioneve në desktop dhe për mobile me kornizën Electron. Shtrirja HTML dhe baza JS shpejt e bënë

Vue një mjet të preferuar të përparmë, të dëshmuar nga adoptimi nga gjigandë të tillë si Adobe, Behance, Alibaba, Gitlab dhe Xiaomi. Vue.js bazohet ne arkitekturen mvc(model –view-controller).

### **2.4.3 Përparësitë e Vue.js**

Madhësia e vogël: vetem 18 KB dhe kjo është anë positive sepse ndikon edhe ne SEO(search engine optimization).

Virtual Dom: Kur një përdorues ndërvepron me faqen, objektet ndryshojnë gjendjen e tyre, kështu që një shfletues duhet të azhurnojë informacionin dhe t'i japë ato në ekran. Por, azhurnimi i tërë DOM-it është i ngadalshëm dhe kërkon kohë. Për shkak të shpejtësisë, Vue.js shfrytëzon DOM virtual: Mendoni për këtë si një kopje të një DOM origjinal që gjen se cilat elemente duhet të bëhen update, pa rirenditur të gjithë DOM-in. Kjo qasje e bën shpërndarjen e faqes mjaft të shpejtë dhe përmirëson performancën e aplikacionit.

## **2.5 Krahasimi I Gjuhëve Programuese**

Krahasimi i aplikacionit find-doctor dhe ondemand.com:

### **2.5.1 Node.js VS Java**

Java është një gjuhë programuese e orientuar në objekte, me qëllim të përgjithshëm dhe e bazuar në klasë. Zhvilluesit(programerët) mund të përdorin parimin - "shkruaj një herë, ekzekuto kudo" me Java. Java si gjuhë programuese është e lëvizshme, që do të thotë një program i shkruar për çdo platformë duhet të ekzekutohet në mënyrë të ngjashme në një kombinim të pajisjes dhe sistemit operativ. Node JS është një librari dhe ambient ekzekutimi i cili është ndër-platformor(cross-platform) dhe përdoret për krijimin e aplikacioneve ne javaScript të ekzekutuara jashtë shfletuesit(browserit). Është një burim i lirë (pra open source) dhe i hapur dhe përdoret për krijimin e aplikacioneve nga ana e serverit. Node JS lejon zhvilluesit të ekzekutojnë kodin e tyre nga ana e serverit. Ai siguron një mënyrë më të shpejtë për të shkruar skripta që janë të lehta dhe të shpejta.

## **Java**

Java u zhvillua fillimisht nga James Gosling në Sun Microsystem. Pjesa më e madhe e sintaksës së Java-s rrjedh nga C++, e cila gjithashtu është e bazuar në klasë dhe e orientuar drejt objektit. Java po transportohet në formën e JDK (Java Development Kit), i cili përfshin komponentë të ndryshëm që kërkohen për të ekzekutuar një program java, megjithatë, jo të gjithë përbërësit e JDK janë të detyrueshëm për të ekzekutuar Java. Versioni i fundit është Java 10, lëshuar në Mars 2018. Java ka mbështetje të gjerë për konkurrencën, rrjetëzimin(networking) dhe GUI (Ndërfaqja Grafike e Përdoruesit). Ekziston një numër i madh i frameworks që janë ndërtuar duke përdorur Java. Duhet të sigurohemi se JRE duhet të instalohet në një sistem operativ të kërkuar i cili mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e Java-s. Një përkthyes(compiler) do të shndërronte kodin burimor Java në bytecode, dhe JVM (Java Virtual Machine) e cila është krijuar brenda JRE (Java Runtime Environment) do të shndërronte bytecode në kodin e makinës.

## **Node Js**

Dikush mund të përdorë lehtësisht Node JS për pjesën e front-end, si dhe për zhvillimin e back-end pasi lejon përdorimin e të njëjtit JavaScript. Zhvilluesit mund të shkruajnë aplikacione në kohë reale, dhe në të njëjtën kohë, ajo ofron hapësirë për zhvillimin e aplikacioneve mobile. Aftësitë nga ana e serverit sigurohen gjerësisht në Node JS, një zhvillues mund të dëgjojë dhe t'u përgjigjet kërkesave HTTP në kompjuter, të dëgjojë rrjetin e trafikut dhe në të njëjtën kohë mund të hyjë në bazën e të dhënave nga një kompjuter direkt. Node JS përdor një model të bazuar në ngjarje për të adresuar shkallëzimin dhe për të lejuar librari të pasura JavaScript për modulet JavaScript-it që ndihmon në thjeshtësimin e kodimit. Ka shumë framework të bazuara në Node JS si Express JS, Partial JS, etj. Kur bëhet fjalë për ndërtimin e aplikacioneve të shpejta nga ana e serverit, Node JS është mjaftë i preferueshëm.

JAVA	NODE JS
Gjuha e bazuar në klasë, e orientuar drejt objektit që rrjedh nga C ++	Framework i shkruar në C,C++,Javascript
Kompleks web based, highly concurrent application	Për aplikacione të shpejta në server side
E përshtatshme për projekte komplekse në web	E përshtatshme për projekte me madhësi të vogël
Messaging, web application, highly concurrent application	Highly useful when scalable and faster application is required
Require JDK(Java Development Kit) to run Java	Need to install archive file on system
Dominate server-side interaction	Developers can utilize it on client and server side
Simplify application development with object oriented approach	More suited for application like real time collaborative drawing/edit like Google docs

Tabela2-Krahasimi Java vs Node

Java është një mundësi e shkëlqyeshme për ndërtimin e një aplikacioni kompleks në web, shumë bashkëkohor, ndërsa Node JS është ideale për zhvillimin e projekteve me madhësi të vogël. Java kërkon Java Development Kit i cili përfshin kompajlerin Java dhe runtime environment për të ekzekutuar Java në çdo makinë, ndërsa Node JS duhet të instalohet përmes skedarit(fileve) të instalueshëm të arkivit. Kodi burimor i shkruar në Java përpilohet në bytecode dhe më pas bytecode shndërrohet në kod makine, i gatshëm për t'u ekzekutuar në çdo platformë ndërsa, me Node JS, kodi burimor i shkruar në një skedar burimi është JavaScript, interpretuesi Node JS do të përdoret për të interpretuar dhe ekzekutuar kodin e JavaScript-it. Java është një gjuhë e orientuar drejt objektit duhet të përpilohet dhe ekzekutohet brenda JRE (Java Runtime Environment) ndërsa Node JS është një sistem dhe cross-platform për aplikacione të shkruara në javascript. Detyra intensive e CPU-së që kërkon një fuqi të madhe llogaritëse mund të trajtohet me Java ndërsa operacionet e lidhura me I / O si biseda në kohë reale, transmetimi i mediave etj mund të trajtohen më mirë me Node JS. Për projekte në shkallë të gjerë që përfshinin njëkohësi(concurrency) java rekomandohet shumë ndërsa. Java është gjuha më e popullarizuar e programimit në botë ndërsa Node JS është një framework që është e lidhur ngusht me javascript.

## **Konkluzion**

Java është një gjuhë programimi ndërsa Node JS është një framework e shkruar në C, C ++, JavaScript. Ka shumë gjëra që mund të bëhen me Java në mënyrë efikase, por jo me Node JS dhe anasjelltas. Java ka një grup të gjerë dhe të pasur librarish dhe frameworka të cilat po dominojnë zhvillimin e faqeve në të gjithë globin për vite me rradhë. Node JS është një framework e cila është shumë e përshtatshme për zhvilluesit e JavaScript. Funksionon në mënyrë efikase për klientin dhe pjesën anësore të serverit të një aplikacioni.

Si përfundim krejt varet nga ajo se qfarë po zhvillojm, pra qfarë llojë aplikacioni. Çdo gjë që bëhet me Node JS mund të arrihet në mënyrë efikase me libraritë dhe framworkat. Aplikacionet të shpejta mund të ndërtohen në Java, ndërsa aplikacionet me I / O mund të shkruhen në mënyrë efikase me framworkun Node JS.

### **2.5.2 Krahassimi i front-end: React.js dhe Vue.js:**

#### **React:**

Ndërvepron me dokumentet HTML përmes të ashtuquajturit DOM virtual (d.m.th. një kopje e DOM-it real me të gjitha nyjet të përfaqësuara si objekte javaScripti) dhe ndjek një stil deklarativ të programimit. Qasja e saj e bazuar në komponente ju jep më shumë shpejtësi dhe fleksibilitet kur ndërtoni aplikacione komplekse. Vue.js është një tjetër framework open source për ndërtimin e faqeve komplekse. Përmirëson shumë koncepte që gjenden në Angular dhe React. Vue reklamohet si një framework progresive që do të thotë që ju mund të migroni projektet tuaja ekzistuese në të njëjtën kohë. Në varësi të nevojave tuaja, Vue është midis një frameworku dhe një librerie. Ashtu si React, vue përdorë komponenta, të dhëna dy-drejtimitëshe(two-way data binding), dhe DOM virtual.

